

VITENË VIJIM



plotWAVE T-series

Një printer me ngjyra
ku mund të mbështeteni

Canon

VITET NË VIJIM NJË PRINTER MBI TË CILIN MUND TË MBËSHTETENI



¹ Të gjitha krahasimet e performancës së produktit u referohen serive të mëparshme të printerëve plotWAVE, përveç nëse specifikohet ndryshe.

² Jetëgjatësia ekonomike e pritshme e serisë plotWAVE është 7 vite, duke u bazuar në të dhënat e shërbimit të Canon.

plotWAVE seria T ju ofron teknologji të besuar me fuqi printuese të gjeneratës së re. Është një printer mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim.

Gjenerata e re e printerëve plotWAVE

Kur u hodhën në treg në vitin 2009, printerët plotWAVE ofronin produktivitet të qëndrueshëm dhe të besueshëm të printimeve cilësore dhe një filozofi dizajni që synonte jetëgjatësinë.

Tani, duke u bazuar në mbi një dekadë sukcesi si lider në treg, gjenerata e gjashtë zhvillon akoma më tej konceptin e plotWAVE. Për përdoruesit e vizatimeve dhe të dizajneve teknike, ofron:

- Praktikitet edhe më produktiv¹
- Veçori të përditësuara të sigurisë IT për jetëgjatësinë ekonomike të printerit²
- Mbështetje për nismat tuaja të qëndrueshme të biznesit

Për ju, në mënyrë që të dizajnoni, krijoni dhe formësoni botën tonë


Printerët plotWAVE të serisë T janë krijuar për prodhuesit e skicave dhe dizajneve teknike të cilët duan një zgjidhje të integruar dhe të lehtë në përdorim. Janë krijuar për përdoruesit në kompanitë e arkitekturës, inxhinierisë, ndërtimit dhe prodhimit, si edhe në zyrat qeveritare, në arsim dhe në dyqane printimi profesional të cilat merren me sasi të mëdha dokumentesh teknike.



Dyqane printimi profesional



Arsim



Zyra qeveritare



**DIZAJNONI,
KRIJONI DHE
FORMËSONI
BOTËN TONË**

7 PËRFITIME TË SERISË T PËR JU

Zgjidhje rezistente
printimi

1



Filozofi dizajni
profesional

2

Përdorim i lehtë
dhe produktiv

3





4 Fluks pune i thjeshtuar

5 Veçori të sigurisë së IT-së

6 Mbështetje për nisma të qëndrueshme të biznesit

7 Sportel unik

**ÇDO
DETAJ KA
RËNDËSI**

ZGJIDHJE REZISTENTE PRINTIMI PËR VITET NË VIJIM

Me plotWAVE seria T mund të printoni dokumente komplekse të formatit të madh, me lehtësi dhe detaje të imtësishme. Edhe në kushtet e trajnimit të kufizuar të përdoruesit, plotWAVE seria T ju ndihmon të kufizoni printimet e gabuara falë cilësimeve automatike dhe pamjeve paraprake që paraqesin me përpikëri atë që do të printohet.

Printimi i saktë që në herën e parë ndërthuret me dizajnin solid, me pjesët me jetëgjatësi të konsiderueshme përdorimi dhe me një numër minimal pjesësh të konsumueshme për t'ju ndihmuar me menaxhimin e shpenzimeve.

¹ Opsionale.



**MBËSHTETUR
NË NJË DIZAJN
SOLID**

Përdoruesi në qendër të çdo vendimi mbi dizajnin

Dizajni me përdoruesin në qendër i plotWAVE seria T nuk do të kalojë pa rënë në sy. Ne vendosim përdoruesin në qendër të çdo vendimi që marrim mbi dizajnin. Mund të mbështeteni në përdorimin intuitiv që mësohet shpejt si edhe në printimin produktiv dhe të pambikëqyrrur të kompleteve të mëdha të printimit.

Printerët plotWAVE seria T janë kompakt, ergonomik dhe me nivel të ulët zhurme, çka i bën pajisje të përsosura për zyra të zhurmshme. Me ndërrimin automatik të rullit, optimizimin e fluksit të punës dhe një gamë të plotë pajisjesh periferike¹, ata janë kuaj pune produktivë për biznesin tuaj.

Printerët e serisë T janë projektuar për t'ju ofruar besueshmëri dhe kohë të gjatë funksionimi, pa qenë nevoja për mirëmbajtje të përditshme. Ata janë projektuar për të ofruar cilësi të vazhdueshme printimi, si me kalimin e kohës ashtu edhe në pajisje të ndryshme.



FILOZOFI DIZAJNI PROFESIONAL PËR VITET NË VIJIM

Ne kemi udhëhequr arkitektë, dizajnues dhe inxhinierë drejt mënyrave më të mira të printimit të skicave dhe dizajneve teknike për më shumë se 85 vjet¹. Jemi gjithashtu një nga kompanitë lider në botë të prodhimit, me përvojë të gjerë në fushën e dizajnit dhe inxhinierisë.

¹ Canon u themelua në vitin 1937, më shumë se 85 vite më parë. Océ, pjesë e Canon, ka qenë aktive në printimin e skicave dhe dizajneve teknike që në vitet 1920. Océ ishte furnizuesi lider në botë i printimeve diazo. Më pas shtroi rrugën drejt elektrofotografisë analoge dhe dixhitale, e më vonë asaj me bojë. Në vitet 1980, Océ ishte lider botëror në tregun e printimit të dokumenteve teknike. Sistemet Océ përdoren në shumë nga kompanitë më të mëdha të prodhimit, ndërtimit, infrastrukturës dhe shërbimeve utilitare, si edhe në printerët e punëve që furnizojnë këto industri.

² Në krahasim me teknologjitë e ngjashme në treg.



**85+ VITE
EKSPERTIZË
NË PRINTIM**

Ne e dimë se si profesionistët krijojnë dhe përdorin vizatimet dhe dizajnet teknike. Seria T është projektuar nga profesionistët për profesionistët:

- Teknologji e provuar tek e cila mund të mbështeteni
- Dizajn printeri i fortë si shkëmbi
- Plan i veçorive të sigurisë së IT-së për të mbështetur sigurinë informatike të printerit sot dhe në të ardhmen
- Dizajn i qëndrueshëm që ju ndihmon në mbështetjen e nismave tuaja të qëndrueshme të biznesit
- Ndërfaqe intuitive dhe praktike në përdorim për t'u ardhur në ndihmë përdoruesve në prodhimin e printimeve të sakta që me herën e parë

plotWAVE seria T është një printer i shikave dhe dizajneve teknike tek i cili mund të mbështeteni për vitet në vijim. Teknologjia Radiant Fusing kursen energji ndërkohë që ofron disponueshmëri të menjëhershme dhe printime të cilësisë së lartë. Njësia e shkrirjes nxehtet në pak sekonda, duke kursyer kohë printimi dhe energji në modalitetin e gatishmërisë.

Printerët me Radiant Fusing gjenerojnë gjithashtu më pak zhurmë, më pak nxehtësi² dhe gati aspak ozon. Toneri shkrirhet pa kontakt fizik me materialin, kështu printimet me Radiant Fusing janë të qarta dhe të mprehta, me rrezikshmëri të ulët për turbullim siç mund të jetë rasti me teknologjinë e printimit me rul ngrohës.

PËRDORIM I LEHTË DHE PRODUKTIV PËR VITET NË VIJIM



**NDËRFAQE
INTUITIVE**

plotWAVE seria T ofron praktikitet produktiv për thuajse çdo detyrë, nga një printim i shpejtë deri te punët komplekse dhe kompletet e dokumenteve. Së bashku me PRISMA Tech Suite, ai është një printer ku mund të mbështeteni për vitet e ardhshme.

Printim vërtet me “buton të gjelbër”

plotWAVE T-series tejet produktive ndihmon përdoruesit tuaj të kursejnë kohë dhe përshpejton procesin e dizajnit. Edhe për përdoruesit për herë të parë, ndërfaqja intuitive redukton kohëzgjatjen për ta mësuar në minimum absolut dhe ndihmon në parandalimin e printimeve të gabuara ose vonesave. Thjesht shtypni butonin e gjelbër!

Përdorimi është intuitiv edhe me shikim të parë dhe është projektuar në parimin e praktikitetit në përdorim dhe parimin "tërhiq dhe lësho". Mund të dorëzoni skedarët drejtpërdrejt nga shfletuesi i internetit dhe të printoni drejtpërdrejt nga aplikacionet e përputhshme, me një komplet intuitiv drajverësh.

Thjeshtim i punëve komplekse dhe kompleteve të dokumenteve

Pamjet paraprake të sakta që paraqesin me përpikëri atë që do të printohet ju lejojnë të bëni një inspektim vizual të shpejtë ndërkohë që jeni duke përzgjedhur cilësimet e printimit. Kjo mund të parandalojë gabimet e printimit dhe shpërdorimin e kohës, tonerit dhe letrës.

Nëse keni shumë punë standarde ose përsëritëse, mund të krijoni lehtësisht një shabllon të specializuar të punës për të përshpejtuar punën herën tjetër.

Për sa u përket drajverëve, Canon ka menduar për ju. Driver Select, drajveri i printerëve me format të madh për Windows, është projektuar për të ndihmuar në reduktimin e gabimeve, me qëllim për të dhënë rezultate të sakta që me herën e parë me anë të funksioneve të qarta dhe praktike në përdorim. Driver Express mundëson printimin e skedarëve PostScript nga Mac dhe Windows.

Veçori të fuqishme dhe inteligjente automatizimi

Automatizimi i proceseve është një mënyrë shumë e mirë për të qenë produktiv. plotWAVE seria T ka shumë cilësime dhe sisteme të automatizuara që ju kursejnë kohë, duke reduktuar printimet e gabuara dhe shqetësimet për vitet në vijim.

Radiant Fusing rregullon temperaturën e sistemit për t'iu përshtatur materialit, duke kufizuar printimet e gabuara. Pico Printing përfshin automatikisht pika shtesë për cilësi mbresëlënëse printimi. Kjo sjell si rezultat linja tepër të mprehta dhe aplikim uniform boje njëngjyrëshe.

Kontrolluesi i fuqishëm POWERsync+ mund t'ju kursejë kohë duke bërë të mundur që të skanoni apo fotokopjoni ndërkohë që jeni duke printuar. Veçoritë inteligjente të përdorimit të materialeve si p.sh. zbulimi i gjerësisë së materialit, zbulimi automatik i materialeve të mbetura dhe ndërrimi automatik i rullit ju ndihmojnë të prodhoni shumë printime mbresëlënëse me shumë pak ndërhyrje.



NJË KATALOG PËR ÇDO NEVOJË

PRODUKTIVITETI

plotWAVE
T30

4^{A1}
p/m

2^{rule}



plotWAVE
T35

6^{A1}
p/m

2^{rule}



plotWAVE
T5

8^{A1}
p/m

4^{rule}



AVE
0

plotWAVE
T55

10^{A1}
p/m

4 rule

1 furnizues
fletësh

e
1 furnizues
fletësh



plotWAVE

T75

10^{A1}
p/m

6 rule

1 furnizues
fletësh



FLUKS PUNE I THJESHTUAR PËR VITET NË VIJIM


Siguria SMARTshield ofron mbrojtje

Mbroni informacionet tuaja me vlerë në të gjitha fazat e procesit të printimit.




Paneli i përdoruesit ClearConnect

Printoni, fotokopjoni dhe skanoni me panelin e përdoruesit me prekje të shumëfishtë, po aq thjesht sikur të përdornit një tablet.




Publisher Express

Dorëzoni lehtësisht punët tuaja të printimit me anë të internetit, pavarësisht llojit të shfletuesit të internetit.



POWERsync*

Realizoni produkte cilësore me produktivitet të lartë, duke përdorur ndërfaqen tonë intuitive praktike në përdorim.




Publisher Mobile

Dorëzoni punët e printimit me anë të aplikacionit tuaj celular në telefonat IOS dhe Android.




Drajverët e printerit

Printoni me efikasitet dhe efektshmëri nga çdo aplikacion me drajverët tanë praktikë të printerëve.



Arkitekturë e hapur


Integroni lehtësisht në aplikacionet e menaxhimit të printimit, të tilla si uniFLOW¹ falë kontrolluesit tonë POWERsync*.



¹ Miniaplikacioni uniFLOW vjen i instaluar paraprakisht përmes kontrolluesit POWERsync* të printerit dhe kërkon aktivizim përpara përdorimit me një licencë aktive uniFLOW. Konsultohuni me përfaqësuesin e Canon-it për më shumë informacione.

**PËRDORUESI
NË QENDËR
TË FLUKSIT TË
PUNËS**

Nuk jemi thjesht një nga udhëheqësit e tregut për printerët me performancë të lartë. Jemi gjithashtu zhvillues të mirënjohur të kontrolluesve dhe softuerëve të fluksit të punës që i pajisin arkitektët, dizajnerët dhe inxhinierët me mjetet e nevojshme të punës së tyre.



PRISMA Tech Suite

Krijoni projekte mbresëlënëse ndërkohë që jeni në kontroll të printerit tuaj me anë të zgjidhjeve të fuqishme të fluksit të punës që janë projektuar për t'ju ndihmuar me përdorimin e përditshëm të printerit.



PRISMAproduce Tech

Komponi, menaxhoni dhe dorëzoni komplete të ndërlikuara dokumentesh nga shfletuesi juaj i internetit te një ose më shumë printerë njëkohësisht.



Panel PRISMAlytics

Merrni përmbledhje gjithëpërfshirëse për të monitoruar dhe maksimizuar prodhimtarinë e punimeve tuaja të printimit me këtë mjet të sigurt të menaxhimit të informacionit të bazuar në renë kompjuterike.



PRISMAlytics Accounting

Mblidhni të dhëna për tarifimin e kostove dhe monitorimin e përdorimit me këtë mjet raportimi të bazuar në renë kompjuterike.



PRISMAservice

Maksimizoni kohën e funksionimit me anë të metodologjisë CARE

- Mblidhni të dhënat në distancë
- Analizoni të dhënat
- Riparoni printerët me anë të ndihmës në distancë
- Vlerësoni për përmirësim të vazhdueshëm

Projektuar për proceset tuaja të përditshme

Printerët plotWAVE seria T janë krijuar për t'u përshtatur me proceset që kryeni në përditshmërinë tuaj. Flukset e punës së fotokopjimit¹ dhe skanimit¹ janë të thjeshta falë teknologjisë Image Logic me përmirësim automatik të skanimit. Duhet të printoni diçka? Mund të aksesoni rishikimet tuaja të fundit nga dosja kryesore, reja kompjuterike ose rrjeti lokal. Kontrolluesi POWERsync⁺ është përmirësuar², duke funksionuar tashmë me softuerin e fundit të sistemit operativ Microsoft Windows me harduer më të fuqishëm dhe me më shumë kapacitet memorieje, i projektuar për t'ju dhënë më shumë fuqi printimi.

Printerët plotWAVE seria T ngrohen në pak sekonda, duke ju ndihmuar të reduktoni shpenzimet e energjisë. I ndërthurur me funksionin e ndezjes në distancë, printeri plotWAVE seria T mund të jetë gati për punë kur ju të mbërrini.

Prakticitet ergonomik

Dizajni ergonomik i plotWAVE seria T ju ndihmon të punoni pa mundim, tani dhe në vitet në vijim. Funksionet e përdorimit të materialeve dhe zëvendësimit të rullit si p.sh. zbulimi i gjerësisë së materialeve, zbulimi automatik i materialeve të mbetura dhe ndërrimi automatik i rullit ju ndihmojnë të prodhoni printime pa gabime me shumë pak ndërhyrje. Ndërfaqja ergonomike e përdoruesit funksionon si një tablet dhe mund të rrotullohet dhe anohet në këndin optimal.

Ne investojmë shumë në kërkime lidhur me përdoruesit për të përcaktuar funksionet më të mira të printerëve dhe fluksit të punës për përdoruesit profesionistë. Këto njohuri janë integruar në serinë T për t'ju ndihmuar të përshpejtoni proceset e dizajnit dhe për të shkurtuar kohëzgjatjen e proceseve.

Jemi të përkushtuar ndaj zhvillimit të vazhdueshëm. plotWAVE seria T është një printer mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim.



**GATI
KURDO QË
TË JENI JU**

¹ Opsionale.

² Të gjitha krahasimet u referohen serive të mëparshme të printerëve plotWAVE, përveç nëse specifikohet ndryshe.

³ Opsionale në varësi të konfigurimit të printerit.

Proces më i shpejtë dhe më i lehtë pune për skanimet dhe printimet

plotWAVE T-series prezanton një sërë risish që e bëjnë punën më të shpejtë, më të lehtë dhe më të përshtatshme për përdoruesit. Këto përfshijnë:

- Skanimin dhe printimin nga Microsoft 365: për ngarkim të drejtpërdrejtë pas skanimit ose për printim të drejtpërdrejtë nga SharePoint, OneDrive ose nga vendndodhje të tjera të jashtme.
- Shtimin e datës/orës në emrin e skedarit të skanimit: për garantimin e emrave unikë të skedarëve pa dublikime, renditje të qartë kronologjike dhe gjurmim të pandërprerë të skanimeve
- Emrat e skedarëve të skanimit të personalizuar për përdoruesit: për identifikim të thjeshtë nëpër projekte ose ekipe, kërkim të shpejtë dhe rigjetje të dokumenteve të skanuara, dhe grupim logjik
- Skanimin e ploteve të gjata në PDF: për skanim dhe arkivim të thjeshtë të ploteve me gjatësi deri në 16 m për banderola, harta, diagrame në industrinë e naftës dhe të gazit, plane të rrjeteve utilitare dhe të transportit, etj.

I qëndrueshëm dhe tepër produktiv

Ndërroni materialin shpesh? Në varësi të modelit të plotWAVE seria T që zgjidhni, mund të keni deri në 6 rula materiali dhe 1 furnizues fletësh³. Shpejtësitë e printimit të plotWAVE seria T variojnë nga 4 printime të përmasave A1 ose D në minutë te plotWAVE T30 deri në 10 printime të përmasave A1 ose D në minutë te plotWAVE T55 dhe T75.

plotWAVE seria T ofron gjithashtu një zgjidhje të integruar palosjeje¹ te plotWAVE T50, T55 dhe T75, si edhe një zgjidhje të integruar stivimi në të gjitha modelet. Kjo përfshin produktin tonë të pavarur për volume të larta Scanner Professional II¹, për rritur më tej produktivitetin e skanimeve.

**PËRSHPEJTONI
PROCESET E
DIZAJNIT**



VEÇORI TË SIGURISË SË TI-SË PËR VITET NË VIJIM

Autorizimi

Kufizoni aksesin e paautorizuar në dosjet konfidenciale.

Hapësira ruajtëse e sigurt

Mbroni të dhënat konfidenciale të printerit nga vjedhja ose rrjedhja aksidentale e të dhënave.

Dorëzim i sigurt

Mbroni të dhënat dhe kredencialet e përdoruesit kur dërgoni skedarë në printerin tuaj nga cilado pajisje.



¹ Jetëgjatësia ekonomike e pritshme e serisë plotWAVE është 7 vite duke u bazuar në të dhënat e shërbimit të Canon.

Më shumë se kurrë më parë, ju duhet të mbroni infrastrukturën tuaj të IT-së dhe asetet e të dhënave me vlerë nga aksesit i paautorizuar. Me nivele të shumëfishta të veçorive të sigurisë, plotWAVE seria T është një printer ku ju mund të mbështeteni të qetë për vitet e ardhshme.

Plani ynë për veçoritë e sigurisë TI mbështet sigurinë TI të printerit gjatë jetëgjatësisë së tij ekonomike.¹ Duke u bazuar në cilësimet e përzgjedhura të administratorit të sistemit, do të merrni automatikisht njoftime kur disponohet një korrigjim i ri sigurie Microsoft. Administratorët tuaj mund t'i instalojnë ato nga kompjuterët e tyre, në mënyrën dhe kohën kur dëshirojnë.

Parandalimi i hakimit

Parandaloni aksesin e padëshiruar në printer nga jashtë organizatës tuaj.

Garantoni sigurinë tuaj tani dhe në të ardhmen

Mbajini të dhënat dhe rrjetin tuaj të sigurt tani dhe në të ardhmen me SMARTshield.

**PARANDALIMI
I HAKIMIT**

JU NDIHMOJMË
TË MBRONI TË
DHËNAT TUAJA

NJË VËSHTRIM NGA AFËR I VEÇORIVE TË SIGURISË SË IT-SË TË SERISË T



Projektuar me në fokus për sigurinë e IT-së

Skedarët konfidencialë dhe të kufizuar mund të mbrohen nga aksesit i padëshiruar me anë të niveleve të shumëfishta të masave të sigurisë, si p.sh. kredenciale domeni, identifikim i përdoruesit me LDAP dhe skedarë printimi të mbrojtur me fjalëkalim.

Mund të caktoni një fjalëkalim ose kod për çdo punë për t'ju ndihmuar të mbronit skedarët e printimit me informacione delikate. Kjo mund të ndihmojë në parandalimin e printimeve aksidentale nga përdorues të paautorizuar, në mënyrë që printimet të mos përfundojnë në duart e gabuara ose në koshin e mbeturinave. Softueri uniFLOW i instaluar paraprakisht për printimin dhe menaxhimin në rrjet shton veçori opsionale shtesë të sigurisë TI, me opsione si identifikimi i përdoruesit me kartë aksesit¹.

¹ Miniaplikacioni uniFLOW vjen i instaluar paraprakisht përmes kontrolluesit POWERSync[®] të printerit dhe kërkon aktivizim përpara përdorimit me një licencë aktive uniFLOW.

Konsultohuni me përfaqësuesin e Canon-it për më shumë informacione.

² Jetëgjatësia ekonomike e pritshme e serisë plotWAVE është 7 vite, duke u bazuar në të dhënat e shërbimit të Canon.



SMARTshield mbron të dhënat tuaja

Me teknologjinë SMARTshield, mund të mbështeteni në protokollet e sigurisë, parandaluesit e hakimit dhe enkriptimin e skedarëve për t'ju ndihmuar në mbrojtjen e të dhënave, qoftë atyre të ruajtura apo atyre në transferim e sipër. Asgjësimi i të dhënave dhe protokolle të tjera të fshirjes janë të disponueshme në mënyrë që të dhënat tuaja të mos aksesohen pasi të jenë fshirë.

Veçoritë e forta të identifikimit të përdoruesit të SMARTshield janë projektuar për t'ju ndihmuar në kalimin e dokumenteve vetëm në duart e përdoruesve që duhet të kenë akses në to. Mundësohet gjithashtu menaxhim i qartë dhe i besueshëm për kontrolluesit e buxhetit. Së fundi, kur të jeni gati t'i thoni lamtumirë printerit tuaj plotWAVE T-series, mund dhe t'ia fshini ose hiqni disqet.

Përditësime të sigurisë, tani dhe në të ardhmen, me mbështetje softuerike dhe shërbim në distancë

- Njoftime automatike për korrigjimet e sigurisë, për t'u instaluar sipas specifikimeve të administratorit
- Korrigjimet e sigurisë Microsoft do të jenë të disponueshme gjatë gjithë jetëgjatësisë ekonomike të serisë T²

Mbrojtje për vitet në vijim me SMARTshield CIP (Procesi i Vazhdueshëm i Përmirësimit)

- Ne monitorojmë vazhdimisht pikat e dobëta të sigurisë në kuadrin e gjerë të sigurisë për të përcaktuar nëse është nevoja të zbatohen korrigjime
- Një kompani e jashtme e këshillimit mbi sigurinë kryen testime të depërtimit në mënyrë të strukturuar, për të verifikuar efikasitetin. Testimi bazohet kryesisht në rreziqet kryesore të sigurisë së aplikacioneve sipas Projektit të Hapur Botëror të Sigurisë së Aplikacioneve (OWASP)




SMARTshield

MË SHUMË
SE 85% E
PRINTERIT
MUND TË
RIPËRDORET

MBËSHTETJE PËR NISMAT E QËNDRUESHME TË BIZNESIT PËR VITET NË VIJIM

plotWAVE seria T ju sjell printim kompakt, pa zhurmë dhe ergonomik. Është një printer mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim për të përkrahur nismat tuaja të qëndrueshme të biznesit.

 Kjo shishe përbëhet mesatarisht nga **50%** plastikë e ricikluar post-konsum



Sistemi i mbyllur i tonerit është projektuar për të ndihmuar në kufizimin e tymrave të dëmshëm për shëndetin në ambientin e punës. plotWAVE seria T mbështet materiale pa veshje ose të ricikluara, si edhe heqjen e bojës nga printimet para riciklimit. Seria T është projektuar si një printer i përshtatshëm për ambientet e zyrave, duke emetuar gati aspak ozon dhe shumë pak zhurmë dhe nxehtësi. Ndërfaqja ergonomike e përdoruesit funksionon si një tablet dhe mund të rrotullohet dhe anohet në këndin optimal.

plotWAVE seria T mund t'ju ndihmojë të minimizoni gjurmën e karbonit të biznesit tuaj. Teknologjia Radiant Fusing ndihmon në reduktimin e përdorimit të energjisë, duke i siguruar serisë T etiketën ENERGY STAR për motorët e printerëve. Shishet e tonerëve janë të përbëra prej mesatarisht 50% plastikë PCR. Më shumë se 85% e printerit mund të ripërdoret ose të riciklohet.

SPORTTEL UNIK PËR VITET NË VIJIM

Me plotWAVE seria T profesionistët tanë të kontabilitetit ju ndihmojnë të konfiguroni një zgjidhje tërësisht të integruar për formate të mëdha, me harduerë, artikuj dhe shërbime nga një furnizues i vetëm.

Pa miksim të elementeve nga palë të treta. Përfitoni performancën që ju duhet dhe evitoni shqetësimet, falë një sistemi të integruar.

Mbësht
d

Materiale dhe pjesë të
konsumueshme



Metodat për shitjet
me shërbimet



Përfundimi



Skanerët



Ekosistem i softuerëve të
fluksit të punës

**NJË SISTEM
TËRËSISHT I
INTEGRUAR**

Konfiguroni plotWAVE sipas nevojave tuaja

plotWAVE seria T është vërtet një printer "të-gjitha-në-një", me skanim¹, printim dhe fotokopjim¹. Teknologjia Radiant Fusing dhe shumë veçori të automatizimit inteligjent ndihmojnë në ofrimin e një cilësie të jashtëzakonshme të printimeve, ndërsa teknologjia Image Logic² ndihmon në rritjen e cilësisë së skanimeve dhe fotokopjimeve.


Zgjidhni nga një katalog elementesh dhe pajisjesh periferike¹ me komunikim të pandërprerë në dy drejtime midis printerit, skanerit¹ dhe finitorit¹. Ju nevojitet kapacitet skanimi shtesë? Përmirësoni produktivitetin me mekanizmin e pavarur për volume të larta Scanner Professional II¹.

Ose zgjidhni nga Stacker Select¹ dhe dosjet¹ që janë sintonizuar me printerin tuaj. Për çdo gjë, organizata e shitjeve dhe shërbimeve e Canon ju mbështet në çdo fazë të krijimit të dokumenteve dhe procesit të printimit. Sportel unik praktik.

Një printer mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim.

¹ Opsionale.

² E disponueshme në kombinim me mekanizmin opsional Scanner Express.



NJË KATALOG
MBI TË ÇILIN
MUND TË
MBËSHTETENI

© 2025 Canon Production Printing

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të kopjohet, modifikohet, riprodhohet ose transmetohet në ndonjë formë ose me ndonjë mjet, elektronik, manual, ose ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të Canon Production Printing. Ilustrimet dhe imazhet e nxjerra nga printeri janë simulime dhe nuk vlejnë domosdoshmërisht për produktet dhe shërbimet e ofruara në secilin treg vendas. Canon dhe emrat e produkteve dhe shërbimeve të Canon-it janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Canon, Inc. ose Canon Production Printing Netherlands B.V. Të gjithë emrat e tjerë të produkteve dhe kompanive janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara, janë pronë e pronarëve të tyre dhe janë të mirënjohura.

Canon